

NJEHSIMI I DIPLOMËS UNIVERSITARE

Aplikim për njehsimin e diplomës universitare kryhet vetëm online në portalin e-albania: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853

Aplikimi kryhet sipas procedurës së mëposhtme:

1. Aplikanti plotëson formularin e aplikimit online në portalin e-albania.
2. Aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Diplomën/certifikatën ose dokumentin zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të noterizuar, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licensuar në Republikën e Shqipërisë apo nga përkthyes të licensuar në vendin e origjinës;
 - b. Listën e notave dhe/ose suplementin e diplomës, të noterizuar, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licensuar në Republikën e Shqipërisë apo nga përkthyes të licensuar në vendin e origjinës;
 - c. Fotokopje të kartës së identitetit ose të pasaportës;
 - d. Mandat-pagesën.

Aplikanti, pasi ka përfunduar procedurën e aplikimit online në portalin e-albania, duhet të dërgojë edhe në rrugë postare në QSHA (format hard-copy), dokumentet e përcaktuara në gjuhën a) dhe b) të noterizuara, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licensuar në Republikën e Shqipërisë apo nga përkthyes të licensuar në vendin e origjinës.

Adresa postare e QSHA:

Qendra e Shërbimeve Arsimore, Bulevardi "Zhan D'Ark" Nr. 23, Tiranë, Shqipëri.

Procedurat për njohjen dhe njehsimin e diplomave universitare përfundojnë brenda 45 ditëve, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Aplikimi quhet i plotë vetëm pas përfundimit të aplikimit online, si dhe dërgimit me postë të dokumentacionit përkatës.

Tarifa: 2 000 lekë/për çdo diplomë që kërkohet të njësohet.

Pagesa kryhet në llogarinë bankare të QSHA-së të përcaktuar në faqen web të QSHA-së, në seksionin përkatës të njohjes së diplomave: <http://qsha.gov.al/index.html>.

Informacioni i mësipërm u përditësua sipas Udhëzimit nr.30 dt.30.12.2019 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri (MASR).